



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 31

2000

Tetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr. 8660, datë 18.9.2000	Për ratifikimin e "Kontratës për Blerjen e Aksioneve të Shoqërisë Anonime A.M.C"	1539
Ligj nr.8661, datë 18.9.2000	Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të policisë së shtetit	1556
Ligj nr.8662, datë 18.9.2000	Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike	1564
Ligj nr.8663, datë 18.9.2000	Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 nt	1565
Ligj nr.8665, datë 18.9.2000	Për një shtesë në ligjin nr.7748, datë 29.7.1993 "Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist	1578

Vendim i Kuvendit Nr.456, datë 18.9.2000	Për zgjedhjen e një anëtarit të këshillit mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë	1579
Vendim i KM Nr.520, datë 21.9.2000	Për dhënie fondi për parti të reja politike	1579
	Kërkesë për shpallje të vdekur të Lami Dudës	1580
	Kërkesë për shpallje të vdekur të Arziko Kokalari (Karagjozi) dhe Avni Kokalari	1580

L I G J
Nr.8660, datë 18.9.2000

PËR RATIFIKIMIN E “KONTRATËS PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME AMC”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Kontrata për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime AMC”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe konsorciumit Cosmote/Telenor, i klasifikuar i pari në tenderin për AMC-në.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.2749, datë 22.9.2000, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Kontratë për Blerje Aksionesh

Korrik 25,2000

Kjo kontratë lidhet më 25 korrik 2000

midis

Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, Sheshi Skënderbej, e përfaqësuar nga Shkëlqesia e Tij, Ministri Mustafa Muçi (më poshtë referuar si “Shitësi”)

dhe

Z. Evangelos Martigopoulos dhe Z. Ivar Sliper (më poshtë “Nënshkruesit”), për dhe në emër të Cosmoholding - Albania S.A., një shoqëri në formim e sipër sipas të drejtës së Greqisë, (më poshtë “Blerësi), aksionerët e së cilës janë Cosmote Mobile Telecommunications S.A. dhe Telenor International AS.

Meqënëse ekzistojnë këto Kushte Paraprake

a) Albanian Mobile Communications Sh.A. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), është një shoqëri aksionere shtetërore e krijuar rregullisht sipas të drejtës shqiptare me seli në Tiranë, Laprakë, Rruga Gjergj Legjisi, me kapital aksioner 813,822,000 leke të paguar plotësisht;

b) Shitësi është pronar i 813,822 aksioneve të zakonshme, me një vlerë nominale prej 1,000 lekë secili, që përfaqësojnë 100% të tërë kapitalin e emtuar të Shoqërisë;

c) Blerësi është një shoqëri e specializuar në fushën e telekomunikacionit;

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8515, datë 21.7.1999, “Për privatizimin e shoqërisë aksionere Albanian Mobile Communications (AMC)” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 121/2000 “Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 581, datë 8.12.1999, për kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë aksionere AMC Sh.A.”, datë 18.3.2000, Shitësi ka për qëllim t’i shesë Blerësit një numër prej 691,748 aksionesh të zakonshme të Shoqërisë, që përfaqësojnë 85% të

kapitalit të saj aksioner;

Blerësi ka për qëllim të blejë 691,748 aksione të zakonshme të Shoqërisë, aktualisht të zotëruara nga Shitësi;

Duke marrë në konsideratë sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Përveç termave të tjera të përkufizuara gjetkë në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kudo kuptimin e mëposhtëm:

“Llogari”do të thotë llogaritë e Shoqërisë për vitin finaciar të mbyllur në Datën e Fundit Kontabël, duke përfshirë raportin zyrtar të ekspertëve kontabël të autorizuar mbi këto llogari, raportin përkatës të drejtorëve dhe shënimet për këto llogari;

“Kontratë”do të thotë kjo Kontratë për Blerje Aksionesh, duke përfshirë si një pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, si dhe shtojcat bashkëngjitur të nënshkruara e të shkëmbyera ndërmjet Blerësit dhe Shitësit;

“Mbyllje”do të thotë blerja dhe shitja e Aksioneve, regjistrimi i Blerësit si aksioner i ri, miratimi nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, pagesa e pjesës së Çmimit të pagueshëm në Datën e Mbylljes dhe, në përgjithësi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i gjithë dokumenteve dhe kryerja, përmbushja e gjithë detyrimeve, respektivisht të kërkuara për t’u nënshkruar dhe shkëmbyer, kryer dhe përmbushur në Mbyllje në përputhje me këtë Kontratë me qëllim që të mundësojë Blerësin të bëhet pronar legjitim i 85% të aksioneve të Shoqërisë;

“Data e Mbylljes”do të thotë data në të cilën aktualisht Mbyllja do të kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate, jo më vonë se 30 ditë pas nënshkrimit të saj;

“Konsulentët”do të thotë këshilltarët e Shitësit për transaksionin objekt të kësaj Kontrate, të emërtuar Banca d’Intermediazione Mobiliare IMI S.p.A., Bain Cuneo e Associati Inc. dhe Studio Legale Tonucci – Organizatë Profesionale;

“Parapagesë”do të thotë shuma prej US\$ 1,606,000 (një milion e gjashtëqind e gjashtëmijë), paguar nga Blerësi në Datën e Mbylljes siç parashikohet në nenin 3, paragrafi 3, numri 1 i Kontratës;

“Barrë”do të thotë çdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, kufizim, e drejta e refuzimit të parë, e drejta e parablerjes, e drejtë ose interes e një palë të tretë, barrë ose interesa sigurimi të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë, por pa u kufizuar në transferimin e një titulli ose të një marrëveshjeje mbajtjeje) që kanë pasojë të ngjashme;

“Forca Madhore”do të thotë çdo urdhër, rregullore, ose direktivë qeveritare, e botuar në formën e ligjit ose jo, ose çdo sanksion me natyrë kombëtare ose ndërkombëtare, kryengritje, trazira, trazira civile, luftë (e deklaruar ose jo), aksione ose kërcënime për aksione grupesh ose individësh terroristë apo guerrilie, greva ose lëvizje të tjera sindikaliste, zjarre, përmytje, tërmete, ose ndonjë shkak tjetër që nuk është rezultat i fajit ose neglizhencës së Palëve, ose secilës prej tyre, qofshin ose jo të ngjashme me sa më sipër, me kusht që një ngjarje e tillë të jetë jashtë kontrollit të Palës së dëmtuar.

“Data e Fundit Kontabël” do të thotë 31.12.1999;

“Humbje” ose “Humbjet”do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, humbje ose detyrime të cilat janë pasojë direkte dhe/ose indirekte e shkeljes së parashikimeve dhe garancive të specifikuar në nenin 5;

“Materiale” (dhe variantet e saj)do të thotë, në lidhje me një ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht, se kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht – që veçmas ose së bashku, ka një pasojë e ndikim domethënës ose plotësisht të kundërt (përkeqësues) në gjendjen ekonomike, pasurore, financiare dhe tregtare të Shoqërisë dhe/ose të veprimtarisë së saj në tërësi, në një mënyrë të tillë që vendimi për të kryer transaksionin do të ndikohej në të kundërt kurdo që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht të njihet prej Blerësit, ose që kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht mund të çojë në një Pasoje Materiale Përkeqësuese;

“Pasoje Materiale Përkeqësuese” do të thotë çdo ndikim në aktivitetin e Shoqërisë që passjell një pagesë ose një Humbje, veçmas ose në tërësi, në një shumë jo më të vogël se 50,000 (pesëdhjetë mijë)

dollarë amerikanë;

“Pala” ose “Palët” do të thotë Blerësi ose Shitësi ose të dy së bashku, siç mund të kërkohej në kontekst;

“Çmimi i Blerjes” do të thotë çmimi që Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e Aksioneve siç tregohet në nenin 3 dhe në përputhje me mekanizmin e përcaktuar aty;

“Deklarata për Çmimin e Blerjes” do të thotë deklarata e shkruar, në formën e rënë dakord në Shtojcën A, të nënshkruar nga drejtuesi përkatës i çdo banke të caktuar nga Shitësi – dhe të treguar në tabelën e paraqitur në nenin 3, që vërteton se Çmimi i Blerjes është kredituar në llogaritë e Shitësit ose të personave juridikë të tjerë të caktuar nga Shitësi në ato banka;

“Aksione” do të thotë një numër prej 691.749 aksione të zakonshme plotësisht të paguara të Shoqërisë me një vlerë nominale prej 1,000 lekë secili, numër i barabartë me 85% të aksioneve të emetuara të kapitalit të Shoqërisë. Aksionet përfaqësohen nga çertifikata bashkëngjitur Shtojcës B.

Titujt në këtë Kontratë nuk kanë ndonjë ndikim në interpretimin e saj.

Neni 2

Qëllimi i kësaj kontrate

Në bazë të kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate, në Datën e Mbylljes Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi Aksionet dhe çdo të drejtë që u përket Aksioneve, të lira nga çdo Barrë, për një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 3 dhe në mënyrën e parashikuar po aty;

Mbyllja e transaksionit të parashikuar në këtë Kontratë që do të kryhet në Datën e Mbylljes, do të zhvillohet në zyrat e Shitësit në datën për të cilën do të bien dakord së bashku Palët.

Neni 3

Çmimi i blerjes dhe metoda e pagesës

Çmimi i pranuar për çdo Aksion është 123.7445 dollarë amerikanë (njëqind e njëzet e tre dollarë e 0.7445 cent) dhe, kështu, shuma totale e Çmimit të Blerjes për Aksionet është 85,600,000 dollarë amerikanë (tetëdhjetëepesë milionë e gjashtëqind mijë), dhe do të paguhet në përputhje me dispozitat e parashikuara këtu dhe sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

Të drejtat e dividendëve do të lindin për secilin prej Aksioneve nga Data e Mbylljes.

Shitësi do të paguajë Totalin e Çmimit të Blerjes si më poshtë:

1. Në Datën e Mbylljes, Parapagimi do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë rrjedhëse Nr. 8900405600 e hapur nga Banca d'Intermediazione Mobiliare IMI S.p.A, Swift Code IMITITMM, në Bank of New York, New York Swift Code IRVTUS3N si pjesë e Çmimit total të Blerjes;

2. Në datën e Mbylljes, shuma prej 41,194,000 (dyzet e njëmilion e njëqind e nëntëdhjetë e katërmijë) do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit në Bankën e Shqipërisë në emrin e vet me BIS Bank of International Settlements Basle, Switzzeland, nëpërmjet Rezervave Federale, Banka e Nju Jorkut, Swift Code BISACF ABA No. 021085732;

3. Në ditën e njëqintetëdhjetë pas Datës së Mbylljes, shuma e mbetur prej US\$ 42,800,000 dollarë amerikane (dyzetedy milion e tetëqind mijë) do të paguhet nga Blerësi me transfertë bankare në llogarinë ekzistuese të Shitësit në Bankën e Shqipërisë në emrin e vet me BIS Bank of International Settlements Basle, Switzzeland, nëpërmjet Rezervave Federale, Banka e Nju Jorkut, Swift Code BISACF ABA No. 021085732.

Nëpërmjet kësaj Kontrate, Blerësi është shprehimisht i autorizuar nga Shitësi t'i paguajë Parapagimin drejtpërdrejt Këshilltarëve, në llogarinë bankare të përmendur më sipër, si Shpërblim për Suksesin për shërbimet këshillimore të Konsulentëve në shitjen e Aksioneve, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 12.8.1999.

Në Datën e Mbylljes, Blerësi merr përsipër t'i paraqesë Shitësit një garanci bankare për përmbushjen e detyrimeve, të lëshuar në favor të Shitësit për shumën e barabartë me shumën e mbetur për

t'u paguar sipas paragrafit 3, pika 3, këtu sipër, në formën e përshkruar në Shtojcën C.

Neni 4 **Mbyllja**

Në mbyllje:

a) Shitësi do të:

1. Dorëzojë çertifikatën që përfaqëson Aksionet e regjistruara rregullisht në favor të Blerësit në përputhje me legjislacionin shqiptar;

2. Të nënshkruajë dhe dorëzojë, dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjerë të nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar, për t'i dhënë Blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshëm mbi Aksionet ose për të realizuar në mënyrën e duhur qëllimin e kësaj Kontrate;

3. Të bëjë të mundur dorëheqjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë, duke filluar nga Data e Mbylljes;

4. T'i kthejë Blerësit Garancinë Bankare për Tenderin që i është dorëzuar së bashku me ofertën detyruese.

dhe

b) Blerësi do:

1. T'i dorëzojë Shitësit Mandat Pagesat e Çmimit të Blerjes në shumat e caktuar në nenin 3, paragrafi 3, pikat 1 dhe 2;

2. T'i dorëzojë Shitësit aktet e themelimit dhe dokumentet që vërtetojnë kompetencat e përfaqësuesit të tij, si dhe të gjitha dokumentet e instrumentet e tjera në lidhje me shitjen e blerjen e Aksioneve të parashikuara në këtë Kontratë që mund të jenë të nevojshme për të realizuar qëllimin e saj.

3. T'i paraqesë Shitësit garancinë bankare për plotësimin e detyrimeve në përputhje me nenin 3, paragrafi 5.

Në mbyllje, Blerësi do të fitojë titullin mbi Aksionet në Datën e Mbylljes dhe do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar, si dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to, duke filluar nga Data e Mbylljes.

Shitësi do të bëjë të mundur që në Datën e Mbylljes, ose në çdo datë tjetër pas Mbylljes të vendosur nga Blerësi, thirrjen e mbledhjes së aksionerëve të Shoqërisë, rendi i ditës i së cilës do të përcaktohet në marrëveshje me Blerësin dhe do të përfshijë – ndër të tjera – emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në vend të atyre që do të kenë dhënë dorëheqjen; Blerësi do të ketë të drejtën të përcaktojë emrat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës që do të emërohen pa cenuar kufizimet, në qoftë se ka të tilla, të parashikuara në ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për Shoqëritë Tregtare”, dhe në amendamentet e tij të mëvonshme, si dhe në dispozitat e tjera shqiptare statutores të aplikueshme.

Neni 5 **Deklarimet dhe garancitë e Shitësit**

Shitësi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton në lidhje me Shoqërinë, si dhe me transaksionin të parashikuar prej kësaj Kontrate, të gjitha çështjet që vijnë deri në datën e nënshkrimit të saj. Shitësi gjithashtu garanton se çdo garanci dhe deklarim do të jetë i vërtetë, i saktë dhe joçorientues, sikur të ishte bërë në Datën e Mbylljes.

5.1 Organizimi

Shoqëria është themeluar në mënyrën e duhur dhe ekziston rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk është në pamundësi pagese, dhe është plotësisht e aftë, me të drejta dhe autoritet të plotë, të zhvillojë e kryejë aktivitetin e saj siç e kryen aktualisht dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj siç i zotëron aktualisht. Shoqëria zhvillon aktivitet sipas një liçencë të vlefshme, siç tregohet në Shtojcën E, dhe nuk ka shkelur asnjë prej afateve të kësaj Liçence.

5.2 Autorizimi

Të gjitha aktet legjislative dhe/ose procedurat e tjera të kërkuara prej legjislacionit shqiptar për t'u

marrë nga Shitësi ose në emër të tij, për ta autorizuar atë të lidhë dhe zbatojë këtë Kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Shitësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon ndonjë njoftim të mëtejshëm ose depozitim, aprovim, autorizim, ose ndonjë instrument tjetër, nga ndonjë autoritet publik ndërkombëtar ose kombëtar ose nga ndonjë autoritet tjetër qeveritar ose rregullator.

5.3 Mungesa e Konfliktëve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate, realizimi i transaksionit të parashikuar nga kjo Kontratë dhe plotësimi i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj Kontrate nga Shitësi nuk bie në konflikt, ose nuk rezulton të përbëjë ndonjë shkelje ose mospërmbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anulimin ose përshpejtimin e ndonjë detyrimi ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijon ndonjë barrë mbi ndonjë biznes, aset ose pronë a pasuri të Shitësit, me ose sipas ndonjë dispozite, vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Shitësin.

5.4 Pronësia

Shitësi është pronari dhe përfituesi i vetëm ligjor i Aksioneve në numrin e përcaktuar në nenet 1 dhe 2.

Aksionet janë të përcaktuara dhe të emetuara sipas rregullave dhe janë plotësisht të pagueshme.

Aksionet janë të lira dhe të çliruara nga çdo Barrë e çfarëdo lloji dhe Shitësi do të ketë të drejtë, kompetencë dhe autoritet të plotë për t'i shitur, për t'i kaluar pronësinë e tyre të tretëve, transferuar dhe dorëzuar Aksionet në përputhje me afatet e kësaj Kontrate.

Nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë Barrë në lidhje me Aksionet ose ndonjë numër aksionesh të autorizuar por të pa-emetuara në kapitalin e Shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon të ketë të drejtën e ndonjë Barre në lidhje me ndonjë nga Aksionet.

Përveç kësaj Kontrate, nuk ekziston asnjë kontratë a marrëveshje, rregullim ose detyrim që kërkon krijimin, akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhënien një personi të së drejtës (të kushtëzuar ose jo) të kërkojë akordimin, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni në kapitalin e Shoqërisë (duke përfshirë, pa kufizim, një mundësi ose të drejtë parablerjeje ose kthimi).

5.5 Filialet

Shoqëria nuk ka ndonjë filial.

5.6 Llogaritë financiare

Llogaritë financiare janë përgatitur mbi baza të rregullta e të qëndrueshme në përputhje me të drejtën shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikën e zbatuara ndërkombëtare, dhe në mënyrë të veçantë parimet e kontabilitetit të Komitetit Ndërkombëtar të Standardeve Kontabël (KNSK).

Asnjë ndryshim nuk është bërë në politikën kontabël në përgatitjen e Llogarive të Shoqërisë për secilin nga dy vitet financiare të përfunduara në Datën e Fundit Kontabël, përveç atyre të deklaruar në bilancet dhe llogaritë e fitimeve dhe të humbjeve për këto vite.

Llogaritë paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të aseteve, detyrimeve dhe të gjendjes së aktiviteteve të Shoqërisë siç është në Datën e Fundit Kontabël, si dhe të fitimeve dhe të humbjeve të Shoqërisë për vitin financiar të përfunduar në Datën e Fundit Kontabël.

Nuk ekzistojnë detyrime, pagesa, borxhe dhe, në përgjithësi, rreziqe materiale të Shoqërisë, të cilat nuk janë deklaruar rregullisht dhe në mënyrën e duhur në Llogaritë ose për të cilat të mos jenë akorduar fonde ose rezerva të arsyeshme.

5.7 Regjistrat Kontabël dhe Libra të tjerë të Shoqërisë

Regjistrat kontabël dhe librat e Shoqërisë, në zotërim ose nën kontrollin e saj, janë të azhornuara, të mbajtur në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në regjistrat dhe librat kontabël janë mbajtur në përputhje të plotë me të drejtën shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikën e zbatuara ndërkombëtare.

5.8 Mungesa e ndryshimeve materiale

Biznesi i Shoqërisë është zhvilluar në mënyrë normale, duke e konsideruar atë si një preokupim të vazhdueshëm; dhe asnjë ndryshim thelbësor nuk ka ndodhur në aktivin dhe pasivin e treguar në Llogaritë dhe nuk ka asnjë ulje të vlerës reale neto të aktivit të Shoqërisë në bazë të vlerësimeve të bëra dhe të përlllogaritura në Llogaritë.

Që nga Data e Fundit Kontabël, Shoqëria është drejtuar dhe ka operuar në mënyrën e duhur dhe Shitësi nuk ka dijeni se vetë Shitësi dhe/ose Shoqëria ka:

Hyrë në ndonjë marrëveshje, vlera e të cilave kalon US\$ 10,000, me përjashtim të atyre të raportuar në Shtojcën E, ose

Marrë përsipër ndonjë detyrim ose përgjegjësi materiale, ose

Kryer ndonjë veprim tjetër që mund të shkaktojë që ndonjë nga deklaratat ose garancitë e Shitësit që përmbahen në këtë Kontratë, të bëhen të pavërteta ose të parregullta.

Që prej 15.7.2000 Shoqëria nuk ka:

a) pësuar asnjë ndryshim material dhe përkeqësues në asetet, pronat ose në aktivitetet e saj të biznesit;

b) pësuar asnjë ngjarje ose rrethanë materiale në lidhje me asetet, biznesin ose pronat e saj, që rrezikon materialisht të pengojë, ndalojë, dëmtojë ose të cenojë në ndonjë mënyrë tjetër materiale dhe përkeqësuese rezultatet e veprimtarisë së saj në tërësi;

c) hyrë në asnjë transaksion ose kontratë, ose nuk ka ndryshuar ose përfunduar asnjë transaksion ose kontratë që në mënyrë të arsyeshme mund të sillte një pasojë materiale dhe përkeqësuese për asetet, pronat dhe aktivitetet e biznesit të saj;

d) shitur, transferuar, vënë peng, dhënë me qira ose disponuar në ndonjë mënyrë tjetër asetet ose pronat që ajo zotëron;

e) punësuar personel ose nuk e ka rritur shkallën e kompensimit të pagueshëm ose që do të bëhet i tillë ndaj punonjësve, përveç rritjes të bërë sipas praktikave të mëparshme në përputhje me çdo shpërblim ekzistues ose me plane të tjera, ose nuk ka ndryshuar organizimin e punës së saj në asnjë mënyrë materiale;

f) fituar asnjë pasuri të palujtshme ose nuk ka bërë as edhe një shpenzim kapitali (prekshëm ose të paprekshëm) që kalon shumë US\$ 10,000 ;

g) fituar ose poseduar, në çfarëdo lloj forme, interesa në kapitalin e shoqërive të tjera ose nuk ka fituar, poseduar ose hyrë në marrëdhënie qiraje (si qiramarrës ose qiradhënës) për ndonjë biznes ose pjesë biznesi;

h) deklaruar ose paguar asnjë dividend me përjashtim të shumës 100,000 lek që është pjesë e dividendit të 1999, ose nuk ka blerë ose fituar në ndonjë mënyrë tjetër interesa në pasurinë e saj (equity);

i) rënë dakord për të bërë ndonjë nga të mësipërmet.

Shitësi garanton se pas Ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, Shoqëria nuk do të bëjë asnjë shpenzim ose nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim pa miratimin paraprak nga ana e Përfaqësuesit të Blerësit.

5.9. Taksa dhe Konfliktet

Shoqëria ka depozituar, në kohën e duhur, të gjitha deklaratat për taksat periodike dhe vjetore që parashikohen në ligjet për taksat që zbatohen për Shoqërinë. Këto deklarata tatimore janë përgatitur rregullisht dhe në mënyrën e duhur dhe të gjitha taksat dhe detyrimet direkte ose indirekte të pagueshme, janë paguar plotësisht dhe në kohë. Për sa më sipër është lëshuar nga Autoritetet tatimore shqiptare një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore ashtu siç tregohet në Shtojcën F.

Nuk ekziston asnjë konflikt në proces ose potenciali, me përjashtim të atyre të treguara në Shtojcën G.

Në lidhje me çështjen gjyqësore në proces kundër autoriteteve tatimore shqiptare për llogaritjen e gabuar të humbjeve nga konvertimi i valutës së huaj për vitin 1997 (shiko Shtojcën G), në rast se Shoqëria do të ndëshkohet, me vendim të formës së prerë, për të paguar shumë e kërkuar nga autoritetet tatimore ose ndonjë shumë tjetër që vendoset nga gjykata, Shitësi do ta lirojë Blerësin nga pagimi i një shume të tillë të përcaktuar në vendimin e mësipërm.

5.10. Asetet e Prekshme

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë dhe të tregtueshëm mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, të renditura në Shtojcat H, I, dhe J (duke përfshirë pronat individuale dhe të paluajtshme) që ose janë pasqyruar në Llogaritë e Datës së Fundit Kontabël ose që janë fituar pas kësaj Date, dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrim ose të drejtë të çfarëdo lloji në përfitim të të tretëve.

5.11 Asetet e Paprekshme

Shoqëria është pronarja e vetme dhe ekskluzive e markave tregtare, patentave, e emrave tregtarë, know-how-ve dhe të çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për zhvillimin e biznesit të saj siç tregohet në Shtojcën K, si dhe ka të drejtë t'i përdorë këto, dhe nuk ka cënuar asnjë markë tregtare, patentat, emër tregtar, dhe know - how, dhe asnjë të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale.

Shoqëria është liçencuar në mënyrën e duhur për përdorimin e softuerëve të saj.

Këto asete të paprekshme janë plotësisht të përdorshme nga ana e Shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë licence, tarife ose të ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

5.12 Marrëveshjet

Shoqëria nuk është palë në ndonjë marrëveshje me shkrim që nuk është përmbushë plotësisht, me përjashtim të atyre të deklaruara dhe të evidentuara nga Shitësi sipas dokumentacionit të bashkëngjitur kësaj Kontrate siç përcaktohet në Shtojcën L.

5.13. Punonjësit

Shoqëria nuk është dhe nuk ka qenë kurrë palë e ndonjë kontrate punësimi ose në ndonjë kontratë tjetër angazhimi me ndonjë palë të tretë. Shoqëria nuk është palë në ndonjë kontratë shitjeje, agjencie, komisioni ose konsulence.

Të gjithë Punonjësit janë të regjistruar rregullisht në librat dhe regjistrat përkatës, së bashku me shpërblimet totale që i paguhen secilit prej tyre, në përputhje me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Lista e punojësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre janë paraqitur në Shtojcën M.

Shoqëria ka bërë të gjitha depozitimet dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet që kërkohen për t'u bërë ose për t'u ndërmarrë sipas ligjeve e rregullave të zbatueshme për sigurimet shoqërore, për punën dhe mirëqënien në lidhje me secilin nga Punonjësit. Të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe mirëqënien në bazë të ligjeve dhe rregullave, si dhe të kontratës kolektive, nëse ka të tillë, janë paguar plotësisht.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, të bordit të drejtorëve ose çdo ekspert kontabël i Shoqërisë dhe çdo punonjës ka marrë vitin e fundit financiar vetëm shumat e paraqitura në Llogaritë dhe asnjë nga ata nuk ka të drejtë të marrë ndonjë shumë tjetër përveç atyre të treguara në këto Llogari.

5.14. Pajtueshmëria me ligjin

Shoqëria e ka drejtuar biznesin e saj në të gjitha aspektet materiale në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregullat përkatëse shqiptare. Deri në Datën e Mbylljes, Shoqëria nuk ka shkelur asnjë statut, ligj, rregull, rregullore, urdhër, dekret, direktivë, leje ose kërkesa të ngjashme të zbatueshme ndaj aseteve dhe pronave (qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme, të prekshme ose të paprekshme të zotëruara, të liçencuara, të disponuara me qira ose ndryshe) ose ndaj kontratës dhe të drejtat të parashikuara prej saj, të cilat mund të kenë një Pasojë Materiale Përkeqësuese mbi aktivitetin e saj.

Shoqëria zotëron në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme, pa i shkelur ato, të gjitha lejet materiale, liçencat dhe miratimet ose autorizimet e tjera që kërkohen nga statutet, ligjet, rregullat, rregulloret, urdhrat, dekretet ose direktivat e zbatueshme, në lidhje me pronësinë, përdorimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e biznesit të saj ose të çdo aseti dhe prone të saj ose të çdo kontrate dhe të drejte me të cilat Shoqëria është e lidhur.

5.15 Garancitë, Detyrimet dhe Dëmshpërblimet

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë kapital hua, as të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes me përjashtim të atyre të treguara në Shtojcën N.

Shoqëria nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje garancie, dëmshpërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose

detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një palë të tretë.

5.16 Mbyllja e Shoqërisë, vënia në administrim dhe pamundësia e pagesës

Asnjë urdhër nuk është nxjerrë, asnjë ankesë nuk është paraqitur, ose asnjë vendim nuk është marrë për mbylljen e Shoqërisë ose për emërimin e ndonjë likuidatori të përkohshëm për Shoqërinë, si dhe asnjë urdhër nuk është nxjerrë për vënie në administrim të Shoqërisë; dhe Shoqëria nuk është e insolvente ose e paafte të paguajë borxhet e saj.

5.17 Pullat e taksës, taksat dhe detyrimet e tjera

Nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pullat, taksa ose detyrime të tjera në lidhje me këtë Kontratë dhe me transferimin e aksioneve në emër të Blerësit.

5.18 Shtojcat

Shtojcat e mëposhtme që i janë bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohen si pjesë përbërëse e saj:

Shtojca A: Deklarata e Çmimit të Blerjes;

Shtojca B: Certifikata e Aksioneve;

Shtojca C: Garanci Bankare;

Shtojca D: Liçenca e Shoqërisë;

Shtojca E: Marrëveshjet e nënshkruara nga Shoqëria;

Shtojca F: Raporti mbi çështjet tatimore;

Shtojca G: Raporti në lidhje me çështjen në proces;

Shtojca H: Lista e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;

Shtojca I: Lista e stacioneve ekzistuese bazë të Shoqërisë;

Shtojca J: Lista e pajisjeve dhe aseteve të Shoqërisë (inventari);

Shtojca K: Lista e licencave për markat tregtare, patentat dhe softuer-ët e Shoqërisë;

Shtojca L: Lista e kontratave të qirasë të nënshkruara nga Shoqëria për Pasuritë e paluajtshme;

Shtojca M: Lista e punonjësve të Shoqërisë dhe pagat e tyre;

Shtojca N: Kontratat e huasë të nënshkruara nga Shoqëria;

Shtojca O: Plani i Biznesit i Blerësit.

Për të shmangur çdo dyshim, Shitësi garanton dhe deklaron se përmbajtja e shtojcave të mësipërme është e vërtetë dhe e saktë dhe do të jetë e tillë në Datën e Mbylljes.

Neni 6

Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit

Blerësi i bën deklaratimet dhe i jep garancitë e mëposhtme Shitësit. Secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në Datën e Mbylljes.

6.1 Organizimi

Blerësi është një shoqëri e themeluar, e organizuar dhe që ekziston rregullisht sipas të drejtës greke, me aftësi pagueuse, me kompetencë dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e saj, siç e kryen aktualisht, dhe të zotërojë asetet dhe pronat e saj, siç i zotëron aktualisht.

6.2 Autorizimi

Të gjitha aktet e Shoqërisë dhe/ose procedurat e tjera që kërkohet të ndërmerren nga ose për t'u marrë nga ose në emër të Blerësit, për ta autorizuar atë të lidhë dhe zbatojë këtë Kontratë, janë ndërmarrë rregullisht dhe në mënyrën e duhur, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Blerësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe të detyrueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk kërkon ndonjë njoftim të mëtejshëm ose depozitim, aprovimin, autorizimin, ose çfarëdo instrumenti tjetër, nga ndonjë autoritet publik ndërkombëtar ose kombëtar ose nga ndonjë autoritet tjetër qeveritar ose rregullator të vendit të Blerësit.

6.3 Mungesa e Komisionerëve

Blerësi nuk ka detyrime për të paguar ndonjë komision, tarifë ndërmjetësimi ose pagesa të ngjashme ose komisione në lidhje me transaksionin e parashikuar në këtë Kontratë, pagimi i të cilave të mund të kërkohej në mënyrë të vlefshme nga Shoqëria ose Shitësi.

6.4 Mungesa e Konfliktëve

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate, realizimi i transaksioneve të parashikuara nga kjo Kontratë dhe plotësimi i kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj Kontrate nga Shitësi nuk bie në konflikt, ose nuk rezultojnë në përbërje ndonjë shkelje ose mospërbushje, ose të krijojë ndonjë të drejtë për prishjen a përfundimin, anulimin ose përshpejtimin të ndonjë detyrimi ose humbje të ndonjë përfitimi material, ose nuk krijojnë ndonjë barrë mbi ndonjë biznes, asetet ose pronë a pasuri të Shitësit, me ose sipas ndonjë dispozite të (i) statutit të Blerësit ose të dokumenteve të tjera të themelimit, ose (ii) të ndonjë kambiali, bonoje, hipoteke, porosi, deed of trust¹, licencë, qira, kontratë ose marrëveshje, në të cilat Blerësi është palë, ose (iii) të ndonjë vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Blerësin ose mbi biznesin, asetet ose pronat e Blerësit.

Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk përbën shkelje të ndonjë ligji ose dhe të vetë akteve të Shoqërisë të Blerësit që mund të ndikojë në vlefshmërinë ose në forcën detyruese të kësaj Kontrate.

Neni 7

Detyrime të tjera të Blerësit

7.1 Mbajtja e selisë në Shqipëri

Blerësi do të mbajë selinë e Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

7.2 Investimet dhe plani i biznesit

Blerësi do të zhvillojë, me përpjekjet e tij me të mira, aktivitetet e telefonisë së lëvizshme të Shoqërisë me qëllim që ta bëjë këtë biznes më konkurrues dhe efektiv në treg në përputhje me planin e tij të Biznesit, siç përshkruhet në Shtojcën O.

Në mënyrë të veçantë, Blerësi do të zbatojë brenda periudhës së parashikuar të paktën 60% (gjashtëdhjetë) të shumës së investimeve të përshkruar në planin e biznesit.

Në rast se pas tre vjetësh nga nënshkrimi i kësaj Kontrate, Blerësi nuk do të ketë plotësuar detyrimet e mësipërme, në lidhje me investimet e parashikuara deri në vitin e tretë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën prej US\$ 1,500,00 (një milion e pesëqind mijë dollarë), me përjashtim të rastit kur mosplotësimi i tyre nuk varet prej Blerësit për çfarëdolloj arsye.

Neni 8

Kushtet e mbylljes

Detyrimi i Blerësit për të blerë Aksionet dhe detyrimi i Shitësit për t'ia shitur ato Blerësit Aksionet janë objekt i plotësimit ose i heqjes dorë, në ose përpara Datës së Mbylljes, të kushteve të mëposhtme:

8.1 Autorizimet

Të gjitha autorizimet, pëlqimet, urdhrat ose miratimet, ose deklaratat, ose depozitimet, ose skadimi i afateve të periudhave pritëse, të vendosura nga ndonjë entitet ose autoritet qeveritar, të nevojshme për realizimin e shitjes dhe të blerjes do të jenë marrë, depozituar ose të jenë lëshuar, ose sipas rastit, Autoriteti kompetent do të ketë hequr dorë prej tyre. Në mënyrë të veçantë, me kërkesën e Shitësit, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë do të marrë vendimin për ta paraqitur këtë Kontratë për ratifikim në Kuvend, ratifikim i cili do të bëhet përpara pagimit të shumës së parashikuar në nenin 3, paragrafi 3, numri 3.

8.2 Mungesa e vendimeve ose kufizimeve

¹ Institut i së drejtës angleze, shumë i ngjashëm me lënien në hipotekë, sipas të cilit titulli i ligjshëm mbi një pasuri të paluajtshme i kalon një ose më shumë dorëzanësve, për të siguruar pagimin e një shume parash ose plotësimit të detyrimeve të tjera.

Asnjë ligj i zbatueshëm ose vendim i miratuar, i hyrë në fuqi, i shpallur ose i detyrueshëm ose i nxjerrë nga ndonjë entitet qeveritar, as edhe ndonjë kufizim a ndalim tjetër ligjor, që pengon ose ndalon kryerjen e blerjes dhe shitjes së Aksioneve, nuk do të ketë fuqi juridike.

8.3 Kushtet për Detyrimet e Blerësit

Detyrimi i Blerësit për të blerë Aksionet dhe për të bërë pagesat për to në Mbyllje është objekt të plotësimit ose të heqjes dorë nga Blerësi, në ose përpara Datës së Mbylljes së kushteve të mëposhtme:

(a) Deklarimet dhe Garancitë

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit të bëra në këtë Kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, si dhe në momentin përkatës të Mbylljes, sikur të jenë bërë në atë kohë, përveç rastit kur vlefshmëria e këtyre deklaratave dhe garancive ka shprehimisht një datë më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale, në këtë datë më të hershme), përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një Pasojë Materiale Përkeqësuese.

(b) Plotësimi i Detyrimeve të Shitësit

Shitësi do të ketë kryer ose përmbushur në të gjitha aspektet materiale të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo Kontratë për t'u kryer ose përmbushur nga ana e Shitësit në kohën e Mbylljes, përveç rasteve që, veç e veç ose në tërësi, nuk ka të ngjarë që në mënyrë të arsyeshme të sjellin një Pasojë Materiale Përkeqësuese.

(c) Mungesa e Proceseve

Në kohën e Mbylljes nuk do të ketë procese të filluara e të papërfunduara: (i) që kundërshtojnë, kufizojnë ose ndalojnë shitjen dhe blerjen e Aksioneve prej Blerësit, (ii) që ndalojnë ose kufizojnë pronësinë ose menaxhimin prej Shoqërisë të ndonjë pjese materiale të biznesit ose të aseteve të Shoqërisë, (iii) që kërkojnë vendosjen e kufizimeve në aftësinë e Blerësit për të fituar, mbajtur ose ushtruar të drejtat e plota të pronësisë mbi Aksionet, (iv) që kërkojnë të ndalojnë Blerësin të kontrollojë efektivisht ndonjë pjesë materiale të Shoqërisë; me kusht që nga ky kusht të jetë hequr dorë nga Blerësi për ndonjë padi, ankim ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga ndonjë entitet qeveritar) dhe në qoftë se Shitësi do t'i sigurojë Blerësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshme për Blerësin, në formë e përmbajtje, për këto padi, ankime ose procedime.

8.4. Kushte për Detyrimet e Shitësit

Detyrimi e Shitësit për të shitur, transferuar dhe dorëzuar Aksionet është objekt i plotësimit (ose i heqjes dorë nga Shitësi), në ose përpara Datës së Mbylljes, i kushteve të mëposhtme:

(a) Deklarimet dhe Garancitë

Deklarimet dhe Garancitë e Blerësit të bëra në këtë Kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe në kohën e Mbylljes sikur të ishin bërë në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci i referohen shprehimisht një datë më të hershme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektat materiale, në këtë datë më të hershme).

(b) Plotësimi i Detyrimeve të Blerësit

Blerësi do të ketë kryer ose përmbushur në të gjitha aspektet materiale të gjitha detyrimet dhe marrëveshjet e kërkuara nga kjo Kontratë për t'u kryer ose përmbushur në kohën e Mbylljes.

(c) Mungesa e Procedimeve

Nuk do të ketë procedime të filluara ose të papërfunduara nga ndonjë entitet qeveritar (ose procedime nga ndonjë person tjetër me mundësi të arsyeshme për të patur sukses), që kundërshtojnë ose kërkojnë kufizimin ose ndalimin e shitjes dhe blerjes së Aksioneve, ose që kërkojnë të përfitojnë nga Shitësi në lidhje me blerjen dhe shitjen e Aksioneve të ndonjë dëmi që është material në lidhje me Shitësin; me kusht që nga një detyrim tillë të jetë hequr dorë nga Shitësi në lidhje me ndonjë padi, ankesë ose procedim (me përjashtim të ndonjë padie, ankimi ose procedimi nga një entitet qeveritar) dhe në qoftë se Blerësi i siguron Shitësit dëmshpërblim të kënaqshëm në mënyrë të arsyeshme për Shitësin, në formë dhe përmbajtje, në lidhje me këto padi, ankime ose procedime.

Neni 9

Dëmshpërblimi nga Shitësi

9.1 Detyrimet e Shitësit

Shitësi bie dakord të mos dëmtojë ose të kompensojë Blerësin ose Shoqërinë, sipas rastit, sipas kushteve dhe brenda kufijve, të rëna dakord më poshtë, nga çdo humbje që rrjedh nga ose që varet nga fakte ose rrethana të ndodhura përpara Datës së Mbylljes edhe nëse humbja shfaqet pas kësaj date.

Çdo dëmshpërblim për t'u paguar nga ana e Shitësit sipas kësaj Kontrate do të bëhet i pagueshëm vetëm kur Humbja përkatëse, siç vendoset nga një Gjykatë ose autoritet tjetër kompetent, është bërë e pagueshme.

Për qartësi, asnjë shkelje ose shkelje e pretenduar e ndonjë deklarate ose garancie nuk i jep të drejtë Blerësit të dëmshpërblehet, në rast se nga kjo shkelje nuk ka rezultuar ndonjë Humbje për Shoqërinë, siç vendoset me vendim të Gjykatës ose të ndonjë autoriteti tjetër kompetent.

9.2 Ekskluziviteti dhe ndalimi i dublimit të mjeteve mbrojtëse

Është rënë dakord që e drejta për të marrë dëmshpërblim sipas kësaj dispozite, përjashton dhe nuk do të dublohet nga ndonjë e drejtë, mjet mbrojtës, pretendim ose mënyra të tjera mbrojtëse të mundshme për Blerësin në lidhje me shkeljen nga ana e Shitësit të deklarimeve dhe garancive të specifikuara në nenin 5.

9.3 Përjashtimet dhe kufizimet

Detyrimi për dëmshpërblim i Shitësit sipas kësaj kontrate do të hyjë në fuqi vetëm kur shuma totale e Humbjeve, objekt i kërkesës për dëmshpërblim nga ana e Blerësit në tërësi e kalon shumën US\$ 1,000,000 (një milion), me kusht që nëse ky limit kalohet, Shitësi do të jetë përgjegjës ose i detyruar të paguajë vetëm shumën mbi kufi.

Në asnjë rast shuma totale që duhet të paguhet nga Shitësi si dëmshpërblim në bazë të këtij neni nuk do të kalojë 50 (pesëdhjetë) % të Çmimit të Blerjes.

Shumës që duhet të paguhet nga Shitësi, sipas kësaj dispozite, në lidhje me një kërkesë për dëmshpërblim, do t'i zbritet:

(i) çdo shumë që Shoqëria ka marrë në bazë të çdo politike sigurimi që është në fuqi në datën e kësaj Kontrate ose nga çdo palë e tretë në lidhje me çështjen specifike që është objekt i kërkesës për dëmshpërblim ndaj Shoqërisë;

(ii) çdo përfitim nga taksat në favor të Blerësit ose të Shoqërise si rezultat i ngjarjes që solli pagimin e dëmshpërblimit.

Shitësi do të ketë të drejtën e kompesimit, ndaj çdo Humbjeje e cila është objekt i një pretendimi nga ana e Blerësit, të shumës të çdo aset apo kredie të rastësishëm, që rrjedh ose varet nga rrethanat ose veprimet e ndodhura ose të ndërmarra përpara Datës së Fundit Kontabël dhe që nuk janë pasqyruar në Llogaritë.

Në asnjë rast Shitësi nuk do të jetë përgjegjës ndaj Blerësit në lidhje me ndonjë shkelje të pretenduar të deklaratave dhe garancive, njoftimi i të cilave i është dhënë Shitësit pas 24 muajve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

9.4 E drejta e Shitësit në lidhje me Humbjet

Blerësi bie dakord të njoftojë Shitësin për çdo fakt që mund t'i shkaktojë Shoqërisë një humbje për t'u dëmshpërblyer, për të cilën Shitësi mund të konsiderohet përgjegjës menjëherë pas marrjes dijeni, dhe në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes dijeni, me kusht që në rast se afati i fundit për të depozituar një ankesë ose kundërshtim në lidhje me këtë Humbje është më pak se 30 (tridhjetë) ditë, njoftimi duhet do t'i jepet Shitësit sipas kësaj Kontrate nga Blerësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data që ai ka marrë dijeni për këtë me njoftim me shkrim, ku të tregohen pretendimet që ai synon të bëjë në mënyrë të detajuar dhe të arsyeshme, së bashku me gjithë dokumentacionin që disponon, i cili mund të jetë i nevojshëm për të mundësuar Shitësin për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me Humbjen që është objekt i kësaj kërkesë. Përr qëllimin e kësaj dispozite, dijenia e Shoqërisë do të konsiderohet të jetë edhe dijenia e Blerësit.

Shitësi ka të drejtë të bëjë menaxhimin e rrethanave, të cilat janë shkak për ngritjen e

pretendimeve nga ana e Blerësit dhe Blerësi bie dakord të sigurojë, në bazë të kërkesës së Shitësit, se Shoqëria do të:

(i) mbajë Shitësin të informuar rregullisht dhe menjëherë për çdo njoftim, komunikim ose informacion tjetër në çdo mënyrë të marrë nga Shoqëria në lidhje me një pretendim të tillë,

(ii) bashkëpunojë me Shitësin në lidhje me zhdëmtimet dhe veprimet përkatëse, duke i dhënë Shitësit mundësi të plota për të parë të gjitha shënimet, dokumentet, dosjet dhe të dhënat e lidhura me to, si dhe duke i siguruar mbështetjen e nevojshme nga punonjësit e saj,

(iii) të respektojë çdo udhëzim të Shitësit në realizimin e procedimeve ligjore dhe/ose negociatave zgjidhëse dhe/ose iniciativave të tjera në lidhje me të.

Në qoftë se Shitësi nuk arrin të japë instruksionet menjëherë pas marrjes së njoftimit përkatës nga Blerësi, Blerësi pa shkelur sa me sipër, merr të gjitha hapat e arsyeshme, të cilat mund të kërkojnë për të zvogëluar shumën, për të cilën kërkohej dëmshpërblimi, si dhe mundëson Shoqërinë të ndërmarrë të gjitha këto hapa të arsyeshme; si dhe do ta njoftojë Shitësin plotësisht dhe menjëherë për këto iniciativa dhe hapa.

Marrja nga Blerësi ose Shoqëria e ndonjë iniciative në lidhje me këto pretendime pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit ose mospërmbushja nga ana e Shoqërisë e dispozitave të mësipërme të këtij neni, bën që Shitësi të shkarkohet nga detyrimi për të dëmshpërblyer Blerësin në lidhje me pretendimin përkatës.

Shitësi do të jetë i detyruar të paguajë Blerësin ose Shoqërinë sipas këtij neni, vetëm nëse dhe kur Humbja përkatëse është bërë e pagueshme.

Neni 10

Forca madhore

Mospërmbushja e detyrimeve të marra përsipër sipas kësaj Kontrate prej ndonjëres palë, nuk do të konsiderohet shkelje ose mospërmbushje e kësaj Kontrate, në rast se kjo mospërmbushje vjen si pasojë e një Force Madhore, me kusht që Pala e dëmtuar nga kjo ngjarje:

(a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, kujdesin e duhur dhe masa alternative të arsyeshme, për të plotësuar kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate, dhe

(b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt që është e mundur për këtë ngjarje.

Çdo periudhë, brenda së cilës një Palë, sipas kësaj Kontrate, do të kryejë ndonjë veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën e kohës, gjatë së cilës kjo Palë nuk ishte në gjendje që të kryente këtë veprim për shkak të Forcës Madhore.

Neni 11

Ligji që do të zbatohet dhe juridiksioni

Kjo Kontratë rregullohet nga e drejta angleze.

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me vlefshmërinë, efektivitetin, interpretimin, zbatimin e detyrueshëm dhe mbarimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet përfundimisht nga një trup prej tre arbitrash sipas Rregullave të Pajtitimit dhe Arbitrimit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris dhe gjuha e procedimit të arbitrimit do të jetë gjuha angleze.

Palët me anën e kësaj Kontrate heqin dorë nga zbatimi i ndonjë rregulli tjetër statutor, dhe deklarojnë se njohin Rregullat e Pajtitimit dhe Arbitrimit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Neni 12

Të ndryshme

12.1 Amendamentet

Asnjë amendament, modifikim, mbarim ose heqje dorë nga dispozitat e kësaj Kontrate, nuk do të jetë e vlefshme në asnjë rast në qoftë se nuk bëhet me shkrim dhe nuk nënshkruhet nga ose në emër të

secilës palë.

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejtë ose të ndonjë mjeti mbrojtjeje, të parashikuar nga kjo Kontratë ose me ligji, nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose nga mjeti mbrojtjeje, ose heqje dorë nga të drejta ose mënyra të tjera mbrojtjeje. Mosushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte ose i një mjeti mbrojtës të parashikuar me këtë Kontratë ose me ligji, nuk e pengon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës ose mjetit mbrojtës ose ushtrimin e një të drejtë ose të një mjeti mbrojtës tjetër.

12.2 Ndashmëria

Në qoftë se ndonjë dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate do të jetë i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në ndonjë juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në asnjë mënyrë nuk do të ndikohen ose dëmtohen në ndonjë juridiksion tjetër.

Palët do të përpiqen të zëvendësojnë ndonjë dispozitë të pazbatueshëm ose të pavlefshme në masën më të madhe të mundshme për të arritur qëllimin e dispozitës së pazbatueshme ose të pavlefshme.

12.3 Kopjet

Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në një ose më shumë kopje dhe nga palë të ndryshme në kopje të veçanta, secila prej të cilave e nënshkruar dhe e dorëzuar në këtë mënyrë do të konsiderohet origjinal, por të gjitha këto kopje së bashku do përbëjnë një instrument të njëjtë dhe të vetëm; faqet e firmosura mund të shkëputen nga kopjet e shumëfishta dhe të vecanta dhe mund t'i ngjiten një kopjeje të vetme në mënyrë që të gjitha faqet e firmosura t'i ngjiten fizikisht të njëjtit dokument.

Dokumenti është në versionin anglisht dhe shqip. Në rast konflikti midis dy versioneve, përparësi do të ketë versioni anglisht.

12.4 Njoftimet

Njoftimi ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë Kontratë (më poshtë “Njoftimi”) do të jetë:

me shkrim

në gjuhën angleze; dhe

i dorëzuar ose i dërguar me postë rekomande ose teleks, faks, Palës që duhet ta marrë njoftimin në adresën e caktuar këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo Palë.

Me përjashtim të rasteve kur provohet se është marrë më shpejt, njoftimi konsiderohet i dhënë nëse:

është dërguar me postë 10 (dhjetë) ditë pune pas postimit të tij;

është dërguar me telex, kur përgjigjja përkatëse është marrë; dhe

është dërguar me faks kur konfirmimi i transmetimit është regjistruar nga faksi i dërguesit.

Adresat që u referohen janë:

Blerësi

Emri i Palës: Cosmoholding - Albania S.A.

Adresa: Athens, Kifisias 44

Nr. Faksi: +301.617.75.07

Dërguar në vëmendje të: Ms. Irini Nikolaidi

Shitësi

Emri i Palës: Ministry of Public Economy and Privatisation

Adresa: Tirana, Sheshi Skanderbeg

Nr. Faksi: +355.4.225.154

Dërguar në vëmendje të: Mr. Vasil Pano

12.5 Kalimi i të drejtave

Blerësi nuk mund të japë dhe kalojë ndonjë të drejtë sipas kësaj Kontrate në tërësi ose në veçanti pa pasur më parë pëlqimin me shkrim të Shitësit, pëlqim i cili nuk mund të mos jepet pa arsye.

12.6 Kostot dhe taksat

Me përjashtim kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, secila Palë do të paguajë shpenzimet e veta që lidhen me negociatat, përgatitjet, nënshkrimet dhe realizimin prej saj të kësaj Kontrate dhe të secilit dokument të referuar në të.

12.7 Tërësia e Marrëveshjes
Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.
Shitësi Nënshkruesit
Z. Mustafa Muçi Z. Evangelos Martigopoulos
Z. Ivar Sliper

L I G J
Nr.8661, datë 18.9.2000

PËR SIGURIMIN SHOQËROR SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj u garanton punonjësve të Policisë së Shtetit, që ndodhen në karrierë me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre përfitime suplementare mbi ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Për efekt të përfitimeve nga ky ligj, punonjës të Policisë së Shtetit janë: punonjësit aktivë, në dispozicion, të pezulluar, me pagesë kalimtare, në pension, studentë, kursantë dhe ushtarë (ndihmësagjentë), me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

Neni 2

Përfitimet suplementare, që jepen sipas këtij ligji, garantohen nga Buxheti i Shtetit.

Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve bëhet nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me përjashtim të përfitimeve të përcaktuara në nenet 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij ligji, të cilat zbatohen nga strukturat e Ministrisë së Rendit Publik.

Neni 3

Kontributet

Punonjësit e Policisë së Shtetit paguajnë kontribut shtesë, mbi atë të përcaktuar në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” në masën një për qind të pagës referuese. Për funksionet në rolin madhor, masa e këtij kontributi është dy për qind.

Pjesa që do të paguajë Buxheti i Shtetit do të jetë sa diferenca ndërmjet shpenzimeve për zbatimin e këtij ligji, me të ardhurat që mblidhen nga kontributet që derdhin punonjësit e Policisë së Shtetit.

Kontributet paguhen çdo muaj në Fondin e Sigurimit Shoqëror Suplementar të Punonjësve të

Policisë së Shtetit. Afati i derdhjes është jo më vonë se fundi i muajit pasardhës.

Neni 4 **Fusha e mbrojtjes**

Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për:

- paafësi të përkohshme në punë e shërbim;
- mbulim të shpenzimeve për dëmtime trupore;
- parandalim dhe rehabilitim për sëmundje;
- ç) shpenzime varrimi e ndihme të menjëhershme;
- pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi;
- dh) pension suplementar pleqërie;
- pension suplementar, invaliditeti e familjar;
- ë) pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës.

Neni 5 **Kushtet e përfitimit**

E drejta e përfitimeve suplementare për punonjësit e Policisë së Shtetit varet nga:

- a) koha e shërbimit si punonjës policie, ku përfshihet:
 - koha e punës dhe e shërbimit si punonjës i Policisë së Shtetit , nga grada më e ulët e rolit bazë, në gradën më të lartë në rolin madhor;
 - koha e njohur si ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;
 - koha e ndërprerjes së karrierës për shkak të një vendimi të padrejtë;
 - koha e qëndrimit në dispozicion për shkak të pritjes për sistemim në një funksion tjetër, në përputhje me gradën;
 - gjysma e periudhës së kaluar si punonjës në sektorët civilë, para rekrutimit si punonjës i Policisë së Shtetit (për ata që thirren për të ushtruar specialitete të veçanta, që nuk përgatiten në shkollat dhe në kurset e sistemit të Policisë së Shtetit).

Koha e shërbimit që njihet një fish e gjysmë, për funksione të veçanta miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në çdo rast, periudha gjashtë muaj e një ditë quhet vit i plotë.

- b) paga e realizuar (në vijim: paga referuese), e cila, për efekt të përfitimeve nga ky ligj, është paga bazë mujore së bashku me shtesat me karakter të përhershëm, që përfitonte punonjësi në çastin e ndërprerjes së karrierës, por jo më e vogël se paga që ka përfituar në muajin e fundit kalendarik të shërbimit.

Për rastet kur punonjësit të Policisë së Shtetit e drejta e përfitimit, sipas këtij ligji, i lind më vonë se data e ndërprerjes së karrierës, paga referuese është paga që ai do të përfitonte në çastin e lindjes së të drejtës për përfitim, për funksionin dhe shpërblimin për gradën që kishte në çastin e ndërprerjes së karrierës. Kur funksioni ose grada që kishte përfituesi nuk është më, Ministri i Rendit Publik bën njësimin e tyre me ato që janë në fuqi në çastin e lindjes së të drejtës për përfitim.

Për studentët, kursantët dhe ushtarët paga referuese është paga bazë mujore për gradën më të ulët, në rolin bazë.

PJESA E DYTË
PËRFITIMET SUPLEMENTARE

Neni 6
Pagesa kalimtare

Punonjësit të Policisë së Shtetit, që ndërpret karrierën, i jepet një shpërblim i menjëhershëm, në masën e dy pagave mujore, të muajit të fundit të shërbimit dhe, nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, përfiton pagesë kalimtare, në masën pesëdhjetë për qind të pagës referuese, për atë kohë sa ka vjetërsi shërbimi, por jo më shumë se tre vjet.

Kur punonjësi i Policisë së Shtetit, që ndërpret karrierën, ka më pak se dymbëdhjetë muaj shërbim përfiton vetëm shpërblim të menjëhershëm, në masën e dy pagave mujore, të muajit të fundit kalendarik të shërbimit.

Nuk përfiton pagesë kalimtare punonjësi i Policisë së Shtetit që ndërpret karrierën:

a) në rastet e shkeljeve ose të kryerjes së veprës penale, që dënohet, minimalisht me masën disiplinore përjashtim nga Policia e Shtetit.

b) kur largohet me kërkesën e tij për të filluar një veprimtari tjetër ekonomike ose për punësim në një sektor tjetër;

c) kur dërgohet në një detyrë shtetërore, më të lartë ose paralele, me pagë mujore jo më të vogël se paga që merrte si punonjës i Policisë së Shtetit.

Në rastet kur gjatë trajtimit me pagesë kalimtare ish-punonjësi i Policisë së Shtetit ripunësohet ose dërgohet në një sektor shtetëror (jashtë radhëve të Policisë së Shtetit), me pagë mujore më të vogël, pagesa kalimtare do të jetë një kompensim deri në njëqind për qind të pagës mujore që do të përfitonte punonjësi në çastin e lindjes së kësaj të drejte për gradën dhe funksionin që ka pasur ose, me pëlqimin e tij, ajo ndërpritet, duke shtyrë afatin e njohjes së trajtimit.

Koha e ndërprerjes së plotë të pagesës kalimtare e shtyn afatin e përfitimit të saj, por jo më shumë se koha maksimale e përfitimit.

Periudha e trajtimit me pagesë kalimtare quhet periudhë sigurimi për efekt përfitimi pension pleqërie, invaliditeti e familjar nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Neni 7
Pagesë suplementare për paaftësi të përkohshme

Punonjësi i Policisë së Shtetit, për kohën që është i paaftë, për punë e shërbim dhe plotëson kushtet e përfitimit nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga periudha e sigurimit, përfiton pagesë suplementare që kompenson:

a) njëqind për qind të pagës mesatare ditore, të realizuar në muajin e fundit kalendarik të punës, për katërmbëdhjetë ditët e para të paaftësisë së përkohshme dhe për çdo ditë mbi këtë periudhë në rastet kur paaftësia e përkohshme është rrjedhojë e një aksidenti të ndodhur në krye të detyrës ose për shkak të saj, ose për shkak të një sëmundjeje profesionale;

b) tetëdhjetë e pesë për qind të pagës mesatare ditore, të realizuar në muajin e fundit kalendarik të punës, për çdo ditë mbi katërmbëdhjetë ditët e para, për rastet e tjera, të paparashikuara në shkronjën “a” të këtij neni.

c) shtatëdhjetë për qind të pagës mesatare ditore, të realizuar në muajin e fundit kalendarik të punës, për periudhën e qëndrimit në spital, kur punonjësi ka persona në ngarkim, dhe pesëdhjetë për qind të pagës mesatare ditore, të realizuar në muajin e fundit kalendarik të punës, për periudhën e qëndrimit në spital, kur nuk ka persona në ngarkim.

Paaftësia e përkohshme mbi katërmbëdhjetë ditë përcaktohet nga komisioni mjekësor përkatës dhe zgjat deri në tetëmbëdhjetë muaj për rastet kur paaftësia është rrjedhojë e një aksidenti në punë ose për shkak të detyrës, ose të sëmundjes profesionale dhe deri në dymbëdhjetë muaj për rastet e tjera.

Në rastet kur komisioni mjekësor përcakton se punonjësi nuk mund të riaftësohet për punë e shërbim, përfitimi ndërpritet me caktimin e pensionit të invaliditetit.

Neni 8

Kompensim për dëmtime trupore

Punonjësi i Policisë së Shtetit, në rastet e plagosjes ose të dëmtimeve trupore, përfiton kompensim për shpenzimet e të gjitha llojeve në masën deri në njëqind për qind të shumës që i nevojitet për riaftësim, brenda dhe jashtë vendit, në institucione shtetërore ose private.

Kriteret përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 9

Shpenzimet për rehabilitim shëndetësor

Shpenzimet, për trajnimin dhe ritrajnimin e punonjësit të Policisë së Shtetit, që vuan nga një dëmtim shëndetësor, për rikthimin e aftësive të humbura përballohen nga Buxheti i Shtetit.

Rastet dhe kriteret për përfitim përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 10

Ndihmat e menjëhershme

Çdo paraardhës, pasardhës dhe bashkëshortja(ti), me të cilët punonjësi i Policisë së Shtetit bashkëjetonte para vdekjes ose plagosjes, përfiton ndihmë të menjëhershme, në masën dhe sipas kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Në çdo pesë vjet të përkujtimit të vdekjes, përfituesve të mësipërm u jepet ndihmë deri në pesë paga bazë mujore për gradën më të lartë, në rolin e mesëm.

Masa konkrete e ndihmës miratohet nga Ministri i Rendit Publik.

Neni 11

Shpenzimet e varrimit

Paraardhësve, pasardhësve ose personave që organizojnë funeralin dhe paguajnë shpenzimet e varrimit të ish-punonjësit aktiv të Policisë së Shtetit, në dispozicion, të pezulluar, me pagesë kalimtare, në pension, student, kursant ose ushtar (ndihmësagjent) u paguhen shpenzime shtesë varrimi, në masën dhe sipas kriterëve që përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 12

Pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi

Punonjësit e Policisë së Shtetit, që ndërpresin karrierën ose mbushin moshën e daljes në pension të plotë pleqërie, deri në çastin e daljes në pension të plotë pleqërie, përfitojnë pension të parakohshëm, në masën pesëdhjetë për qind të pagës referuese, kur kanë, të paktën, vjetërsi shërbimi, burrat pesëmbëdhjetë vjet dhe gratë dymbëdhjetë vjet dhe kanë arritur moshën dyzet e shtatë vjeç burrat dhe dyzet e dy vjeç gratë.

Për çdo vit tjetër vjetërsie shërbimi mbi kufirin e mësipërm, masa e pensionit të pjesshëm shtohet me dy për qind të pagës së mësipërme, por jo të kalojë masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi jepet pas përfundimit të periudhës së trajtimit me pagesë kalimtare.

Pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi ndërpritet përkohësisht kur përfituesi bëhet ekonomikisht aktiv.

Periodha, gjatë së cilës punonjësi përfiton pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi njihet si periudhë sigurimi, për përfitim të pensionit të pleqërisë, invaliditetit dhe atij familjar, sipas pikës dy të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 13

Pension suplementar pleqërie

Pensioni i Policisë së Shtetit, që përfiton pension pleqërie sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, gëzon të drejtën e një pensioni suplementar, të llogaritur në masën një për qind të pagës referuese për çdo vit shërbimi, por jo më shumë se pesëdhjetë për qind të pensionit të pleqërisë.

Neni 14

Pension suplementar invaliditeti

Punonjësi aktiv i Policisë së Shtetit, që deklarohet invalid dhe përfiton pension invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, gëzon të drejtën e pensionit suplementar, të llogaritur në masën një për qind për çdo vit shërbimi mbi pagën referuese, por jo më shumë se pesëdhjetë për qind të pensionit të invaliditetit.

Kur invaliditeti është shkaktuar në krye të detyrës ose për shkak të saj, masa e pensionit suplementar është deri në kompensim njëqind për qind të pagës referuese, pavarësisht nga vjetërsia në shërbim.

Neni 15

Pension suplementar familjar

Kur punonjësi i Policisë së Shtetit vdes, paraardhësit dhe pasardhësit e tij, përveç pensionit familjar që përfitojnë sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, gëzojnë të drejtën e pensionit suplementar familjar, në masën që vijon:

- pesëdhjetë për qind burri ose gruaja e ve dhe njëzet e pesë për qind, të pensionit suplementar që do të merrte i ndjeri, për çdo jetim, prind, nip/mbesë dhe prind të prindit, por jo më shumë se njëqind për qind të pensionit familjar;

- pesëdhjetë për qind burri ose gruaja e ve dhe njëzet e pesë për qind të pagës referuese të të ndjerit, që ka humbur jetën në krye të detyrës ose për shkak të saj, për çdo jetim, prind, nip/mbesë dhe prind të prindit, por shuma e këtij pensioni me pensionin familjar, të mos jetë më e madhe se njëqind për qind e pagës referuese të të ndjerit.

Kur punonjësi i Policisë së Shtetit vdes në krye të detyrës ose për shkak të saj dhe paraardhësit dhe pasardhësit nuk i kanë kushtet për pension familjar, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, këta të fundit përfitojnë pesëdhjetë për qind të masës së pensionit shtesë të llogaritur.

Në rastet kur përfituesi bëhet ekonomikisht aktiv, pensioni shtesë i llogaritur jepet në masën pesëdhjetë për qind të tij.

Neni 16

Personat joefektivë të Policisë së Shtetit, të cilët, për shkak të kryerjes së detyrave në funksion të Policisë së Shtetit, bëhen të paaftë, pësojnë dëmtime shëndetësore ose humbin jetën, vlerësohen si persona të thirrur (aktivë) në shërbimet e Policisë së Shtetit dhe trajtohen si pjesëtarët efektivë të saj.

Paga referuese për këta persona është paga që ata përfitojnë në qendrën e tyre të punës, por jo më e vogël se paga bazë e gradës më të lartë, në rolin e ulët dhe më të lartë se paga bazë për gradën më të lartë, në rolin e lartë, ndërsa koha e shërbimit, për efekt të përfitimit, llogaritet sipas përcaktimeve në këtë

ligj.

Neni 17

Punonjësit civilë, efektivë në strukturat e Policisë së Shtetit, përveç trajtimeve sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përfitojnë edhe trajtimet e përcaktuara në nenet 7, 8, 10 dhe 11 të këtij ligji.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 18

Personit, të cilit i lind e drejta për më shumë se një përfitim, ka të drejtë të zgjedhë më të favorshmin.

Neni 19

Përfitimet e parashikuara në nenet 7 (paragrafi i 5-të), 8, 9, 10 dhe 11 të këtij ligji i shtrijnë efektet e zbatimit të tyre deri në gjashtëdhjetë ditë pas ndërprerjes së karrierës. Për përfitimet e parashikuara në nenet 14 dhe 15 të këtij ligji, kur pasoja ka lidhje me detyrën e kryer, e drejta e përfitimeve nuk kushtëzohet nga afati kohor.

Neni 20

Përfitimet nga ky ligj nuk tatohen dhe rriten sa herë rriten pensionet e pleqërisë.

Neni 21

Të ardhurat suplementare, të përcaktuara në këtë ligj, nuk i përfitojnë punonjësit që janë përjashtuar nga Policia e Shtetit për braktisje të detyrës ose që janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë.

Në rast fitimi të pafajësisë, këto të drejta përfitohen nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare, ndërsa në rastet e përfitimit nga amnistia ose falja e dënimit përfitimet fillojnë (ose rifillojnë) nga data e hyrjes në fuqi të amnistisë ose faljes së dënimit.

Këto të ardhura pezullohen në çdo rast të arrestimit për vepra penale, që lidhen me ushtrimin e detyrës si punonjës i Policisë së Shtetit.

Neni 22

Përfitimet nga ky ligj jepen pavarësisht nga ripunësimi i personit, me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj.

Neni 23

Ankimet kundër vendimeve për përfitime nga ky ligj bëhen në gjykatë, e cila e zgjidh çështjen përfundimisht.

Neni 24

Deri në hyrjen në fuqi të akteve ligjore, për realizimin e përfitimit të Statusit të Policisë së Shtetit dhe të trajtimit financiar sipas tij, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Pas hyrjes në fuqi të akteve të mësipërme, ligji nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2754, datë 23.9.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr.8662, datë 18.9.2000

PËR TRAJTIMIN SI TITULL EKZEKUTIV TË FATURËS SË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit nr.36 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, është titull ekzekutiv.

Neni 2

Ligji nr.8369, datë 9.7.1998 “Për trajtimin e faturave të konsumit të energjisë elektrike, në ngarkim të subjekteve shtetërore (buxhetore dhe jobuxhetore) dhe të subjekteve private si tituj ekzekutivë” shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2750, datë 22.9.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J
Nr.8663 , datë 18.9.2000

PËR REGJISTRIMIN, KLASIFIKIMIN, MËNYRËN E PËRDORIMIT
DHE KONTROLLIN E MJETEVE LUNDRUESE ME MOTOR,
ME TONAZH NËN 20 NT

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

PJESA E PARË

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon mënyrën e regjistrimit, të klasifikimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese me motor, me tonazh neto të regjistrit nën njëzet ton (20NT) dhe ka për qëllim disiplinimin e përdorimit dhe sigurimin e kontrollit të këtyre mjeteve.

Neni 2
Përkufizimi i mjetit lundrues

Në kuptim të këtij ligji, me mjet lundrues kuptojmë mjetin lundrues me motor, me tonazh nën 20 NT, që ka një fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve më të lartë se 30 kilovatë/orë ose 40,8 kuaj/fuqi HP, të klasifikuar si të tillë nga Regjistri Detar Shqiptar ose nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për mjetet lundruese, objekt i këtij ligji, që mund të përdoren në det, në liqene dhe në lumenj.

2. Ky ligj nuk zbatohet për mjetet lundruese në përdorim të forcave të armatosura, të kapitenerisë së porteve, të forcave të policisë, të doganave dhe të organeve të tjera të parashikuara me ligj.

3. Ky ligj nuk zbatohet edhe për mjetet e përcaktuara vetëm për peshkim, për të cilat zbatohen ligjet në fuqi.

PJESA E DYTË

Neni 4
Respektimi i normave të lundrimit

Mjetet lundruese duhet të respektojnë rregullat e regjimit të lundrimit në det, në liqene e në lumenj, duke përfshirë edhe normat që lidhen me pajisjet e shpëtimit, me sinjalet ndriçuese për lundrimin natën, si dhe me pajisjen me radio ndërlidhjeje, të sintonizuar në frekuencat e ndihmës detare.

Neni 5
Detyrimi i përgjithshëm

Mjetet lundruese, objekti i këtij ligji, duhet të jenë në çdo rast:

- a) të matrikulluara në kapitenerinë e portit ose në zyrat që varen prej saj, përgjegjëse për territorin, dhe që ndodhen pranë liqeneve e lumenjve;
- b) të regjistruara në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.

Neni 6
Procedurat për matrikullimin dhe lëshimin e lejes së lundrimit

1. Kërkesa për matrikullim duhet të paraqitet nga pronari ose nga bashkëpronarët e mjetit lundrues brenda pesë ditëve nga fitimi i së drejtës të pronësisë mbi mjetin lundrues dhe duhet të përcaktojë qëllimin e përdorimit të mjetit, duke i bashkëlidhur dokumentacionin e lëshuar nga Regjistri Detar Shqiptar.
2. Kapiteneria e portit ose zyrat që varen prej saj, përgjegjëse për territorin, dhe që ndodhen pranë liqeneve e lumenjve, pasi të kenë kryer verifikimet e parashikuara nga legjislacioni për lundrimin, bëjnë matrikullimin dhe lëshojnë lejen e lundrimit, sipas modelit të miratuar nga Ministri i Transportit.
3. Numri i matrikullimit dhe emri i mjetit lundrues duhet të vihen në vend të dukshëm.
4. Karakteristikat e numrit të matrikullimit dhe të emrit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Transportit.
5. Leja e lundrimit duhet të jetë një e vetme dhe i lëshohet të interesuarit brenda pesë ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Në leje duhet të shënohen edhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve të mundshëm.

Neni 7
Procedurat për regjistrimin në zyrën e policisë

1. Kërkesa për regjistrim nga pronari ose nga bashkëpronarët e mjetit lundrues duhet t'i paraqitet zyrës së policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, brenda pesë ditëve nga lëshimi i lejes së lundrimit.
2. Kërkesa duhet të përcaktojë qëllimin e përdorimit të mjetit, i cili duhet të përputhet me atë të shënuar në dokumentin e lëshuar nga Regjistri Detar Shqiptar.
Kërkesës duhet t'i bashkëlidhen dokumentet e mëposhtme:
 - leja e lundrimit;
 - b) dëshmia e aftësisë së pronarit ose të bashkëpronarëve ose të personit tjetër të mundshëm, siç parashikohet në shkronjën "c", e lëshuar nga Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve;
 - c) autorizimi i mundshëm me shkrim, i përkohshëm ose i përhershëm, i vërtetuar nga noteri, me anë të të cilit pronari ose bashkëpronarët autorizojnë një person tjetër të drejtojë mjetin lundrues;
 - ç) deklarata me shkrim e vendbazimit të përhershëm të mjetit lundrues;
 - d) dëshmia e penaltetit të pronarit ose të bashkëpronarëve, si dhe të drejtuesit të mjetit në rastin e shkronjës "c".

Neni 8
Të drejtat territoriale

1. E drejta territoriale, sipas nenit 5, përcaktohet në bazë të vendbazimit të përhershëm të mjetit lundrues.
2. E drejta territoriale për lundrimin në det është e kapitenerisë së portit, ndërsa për lundrimin në liqene dhe në lumenj është e zyrave që varen prej saj dhe që ndodhen pranë liqeneve e lumenjve.

Neni 9
Çertifikata e përdorimit

1. Brenda pesë ditëve nga kryerja e regjistrimit, zyra e policisë kufitare u lëshon pronarit ose bashkëpronarëve certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues, modeli i së cilës miratohet nga Ministri i Rendit Publik.

2. Në çertifikatën e përdorimit duhet të shënohen: gjeneralitetet e plota të pronarit, të bashkëpronarëve e të drejtuesit të autorizuar, numri i matrikullimit dhe emri i mjetit lundrues, tipi dhe kapaciteti mbajtës, numri i personave që mund të transportohen, vendbazimi i përhershëm dhe qëllimi i përdorimit të mjetit lundrues.

Neni 10
Paraqitja e dokumenteve

Leja e lundrimit, certifikata e përdorimit, dokumenti i vlefshëm identifikues, dëshmia e aftësisë, si dhe kopja e deklaratës, parashikuar në paragrafët 1 e 2 të nenit 14, duhet, gjatë udhëtimit, të mbahen gjithmonë në mjetin lundrues dhe të paraqiten gjatë kontrolleve me kërkesën e autoriteteve përgjegjëse.

PJESA E TRETË

Neni 11
Importimi

1. Cilido që importon një mjet lundrues, objekt të këtij ligji, përveç ndjekjes së procedurave doganore të parashikuara, duhet të bëjë edhe deklarinë me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga mbërritja e mjetit, në zyrën e policisë kufitare, kompetente për territorin, duke shënuar vendqëndrimin e vet, vendbazimin e mjetit dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.

2. Brenda pesë ditëve nga importimi, pronari ose bashkëpronarët duhet të bëjnë matrikullimin e mjetit lundrues, sipas procedurave të parashikuara në nenin 6 të këtij ligji.

Neni 12
Zotërimi dhe mbajtja

1. Cilido që zotëron ose mban, me çfarëdolloj titulli, një mjet lundrues ose pjesë të tij, duhet të bëjë deklarinë me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga marrja në zotërim ose në mbajtje, në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, duke shënuar gjeneralitetet dhe vendqëndrimin e tij, vendbazimin e përhershëm të mjetit, si dhe gjeneralitetet e pronarit ose të bashkëpronarëve.

2. Zotëruesi ose mbajtësi duhet të mbajnë gjithmonë me vete dokumentet që dëshmojnë matrikullimin dhe regjistrimin e mjetit lundrues.

3. Deklarimi i zotërimit ose i mbajtjes duhet të bëhet sa herë ndryshon vendbazimi i përhershëm i mjetit.

Neni 13
Ndryshimet e kushteve

Pronari ose bashkëpronarët e mjetit lundrues dhe personi i autorizuar, sipas shkronjës "c" të paragrafit 3 të nenit 7, janë të detyruar t'i komunikojnë me shkrim, brenda njëzet e katër orëve nga çasti i ndryshimit, zyrës së policisë kufitare, që ka lëshuar çertifikatën e përdorimit, çdo ndryshim që ka të bëjë me një ose disa nga kushtet e përmendura në nenet 7 e 9 të këtij ligji.

2. Me “ndryshim” nënkuptohet:

- a) ndryshimi i titullarit të pronës, të zotërimit ose të mbajtjes;
 - b) heqja e lejes së lundrimit;
 - c) zëvendësimi i personit të autorizuar për drejtimin e mjetit, në mbështetje të shkronjës "c" të pikës 3 të nenit 7;
 - ç) ndryshimi i vendqendrimit, vendbanimit ose i banesës së personave të mësipërm;
 - heqja ose skadimi i dëshmisë së aftësisë;
 - dh) ndryshimi i vendbazimit të përhershëm të mjetit;
 - ndryshimi i qëllimit të përdorimit të mjetit.
3. Zyra e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, brenda jo më tepër se pesë ditëve nga paraqitja e njoftimit të ndryshimit, duhet të bëjë regjistrimin e ri dhe të lëshojë një certifikatë të re përdorimi.
4. Deri në lëshimin e certifikatës së re të përdorimit, mjeti lundrues nuk mund të zhvendoset nga vendi i ruajtjes, as të përdoret për çfarëdolloj qëllimi.
5. Dëshmia e penalitetit, e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 3 të nenit 7, verifikohet çdo dymbëdhjetë muaj nga zyra e policisë kufitare.

Neni 14

Detyrimet për planet e lundrimit

1. Kur plani i lundrimit parashikon tejkalimin e dy miljeve larg bregut, ose të 0,2 miljeve për Kanalin e Korfuzit, pronari ose personi i autorizuar për drejtimin e mjetit duhet të bëjë një deklaratë me shkrim, të paktën 6 orë para çdo veprimi për zhvendosje, në zyrën e policisë kufitare dhe të kapitenerisë së portit, të vendit të nisjes, të cilat i lëshojnë një kopje të vërtetuar të deklaratës.
2. Detyrimi i parashikuar në pikën 1, qëndron edhe kur plani i lundrimit parashikon kalimin e vijës kufitare shtetëror të Republikës së Shqipërisë.
3. Në deklaratë përcaktohet vendi i mbërritjes për zhvillimin e veprimtarisë së deklaruar më parë, si dhe ora e nisjes dhe e kthimit.
4. Largësia e lundrimit në lumenjtë dhe liqenet që ndodhen në kufirin shtetëror përcaktohet me dispozita të veçanta të miratuara bashkërisht nga Ministria e Rendit Publik dhe ajo e Transportit.

PJESA E KATËRT

Neni 15

Fabrikat dhe kantieret detare

1. Fabrikat dhe kantieret detare, që ndërtojnë, rristrukturojnë, riparojnë ose përfitojnë me çfarëdolloj titulli mjete lundruese, objekte të këtij ligji, mbajnë një regjistër me fletë të numëruara, të vulosura e të firmosura nga drejtuesi i zyrës së policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.
2. Në regjistër duhet të shënohen, në mënyrë kronologjike e pa mbishkrime të palexueshme ose fshirje, të dhënat që kanë të bëjnë me çdo prodhim, rristrukturim e riparim: modeli, numri i matrikullës së prodhimit dhe emri i mjetit, gjeneralitetet e plota të blerësit të pronarit, të bashkëpronarëve ose të ceduesit dhe atij që e ka transportuar mjetin lundrues, si dhe mënyra e pagesës.
3. Përgjegjësi i fabrikës dhe i kantierit detar është i detyruar ta paraqesë regjistrin, për qëllime kontrolli, sa herë që i kërkohet nga autoritetet policore.

PJESA E PESTË

Neni 16

Mjetet lundruese të matrikulluara jashtë shtetit

1. Shtetasi shqiptar, me shtetësi të huaj ose pa shtetësi, pronar, mbajtës ose zotërues i mjeteve

lundruese që nuk janë matrikulluar në Shqipëri, përveç detyrimeve të caktuara doganore, duhet të deklarojë me shkrim, në çastin e mbërritjes në port, praninë e tyre dhe arsyen e ardhjes, si dhe kohën e qëndrimit në ujërat territoriale shqiptare. Kjo deklarata i paraqitet kapitenerisë së portit ose zyrove që varen prej saj dhe që ndodhen pranë liqeneve e lumenjve, si dhe zyrës së policisë kufitare, përgjegjëse për territorin.

2. Nëse këto mjete qëndrojnë në ujërat territoriale shqiptare pa u ankoruar në port, deklarata u dërgohet zyrove, të përmendura në pikën e mësipërme, në çastin e hyrjes në ujërat territoriale shqiptare dhe mund të dërgohet edhe duke përdorur radion e anijes.

3. Përveç sa është parashikuar në pikat e mësipërme dhe detyrimeve të tjera ndaj kapitenerisë së portit, që rrjedhin nga legjislacioni për lundrimin, për pronarët, mbajtësit ose zotëruesit e mjeteve lundruese, të matrikulluara jashtë shtetit, të cilët duan të qëndrojnë në ujërat territoriale shqiptare për një periudhë më të gjatë se shtatë ditë ose duan të zhvillojnë një veprimtari të qëndrueshme në Shqipëri, i nënshtrohen detyrimit të regjistrimit, të parashikuar në nenin 7.

4. Për regjistrimin duhet të paraqiten dokumentet e lundrimit, të lëshuara nga autoritetet e huaja, pranë të cilave është bërë matrikullimi.

5. Dëshmia e penaltetit, parashikuar në shkronjën “d”, të pikës 3, të nenit 7, duhet të paraqitet në rastin kur mendohet të zhvillohet në Shqipëri një veprimtari e qëndrueshme.

PJESA E GJASHTË

Neni 17

Mosplotësimi i kushteve

Cilido që gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 4 të nenit 18, nuk mund të jetë pronar, as mund të mbajë ose të zotërojë mjete lundruese, objekte të këtij ligji, deri në rehabilitimin e tij sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Neni 18

Ndalime

1. Ndalohet regjistrimi në zyrën e policisë kufitare dhe nuk mund të lëshohet certifikata e përdorimit të mjetit kur mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, nuk është matrikulluar paraprakisht, siç parashikohet në shkronjën “a” të nenit 5 të këtij ligji.

2. Ndalohet regjistrimi në zyrën e policisë kufitare dhe nuk mund të lëshohet certifikata e përdorimit të mjetit, nëse kërkesa e parashikuar në pikën 2 të nenit 7 nuk është e plotë dhe nëse asaj nuk i janë bashkëlidhur të gjitha dokumentet e parashikuara në pikën 3 të nenit 7.

3. Ndalohet regjistrimi i mjeteve lundruese në favor të cilitdo që ka qenë i dënuar për:

a) vepra penale të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 79, 87, 100, 101, 102, 103, 104, 109, 110, 111, 114, 114/a, 140, 141, 219-225, 230-234, 278 paragrafi 1 e 2, 283, 284, 285, 297 e 298 të Kodit Penal;

b) krime në fushën e doganave të parashikuara në nenet 276-280 të Kodit Doganor;

c) nëse ka vepruar si anëtar i një organizate kriminale ose bande të armatosur parashikuar në nenet 333 e 334 të Kodit Penal.

4. Personat që kanë marrë certifikatën e përdorimit të mjetit lundrues, kur dënohen për veprat penale të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, çregjistrohen.

5. Ndalohet përdorimi i mjeteve lundruese të pamatrikulluara, të paregjistruara ose që nuk kanë certifikatë përdorimi.

PJESA E SHTATË SANKSIONET

Neni 19

Regjistrimi dhe lëshimi i paligjshëm i certifikatës së përdorimit

1. Regjistrimi ose lëshimi i certifikatës së përdorimit të mjetit lundrues me dashje nga oficeri ose agjenti i policisë, në kundërshtim me dispozitat e parashikuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 18, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Shkelja, e parashikuar në pikën e mësipërme, e kryer nga oficeri ose agjenti i policisë, nga pakujdesia, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë prej 10.000 (dhjetë mijë) lekësh.

Neni 20

Mospasja e dokumenteve gjatë lundrimit

1. Mospasja në bordin e mjetit lundrues, të dokumenteve të përmendura në nenin 10, gjatë kontrollit të policisë, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me një gjobë nga 10.000 (dhjetë mijë) deri në 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
2. Në rastin e parashikuar në pikën 1, mjeti lundrues i nënshtrohet bllokimit administrativ deri në verifikimin e identitetit të pronarit, të bashkëpronarëve, të mbajtësit, të zotëruesit ose të drejtuesit të mjetit lundrues.
3. Në procesverbalin e konstatimit të shkeljes, një kopje e të cilit i jepet zotëruesit ose mbajtësit të mjetit lundrues, duhet të shënohet detyrimi i pronarit, i bashkëpronarëve ose i drejtuesit të mjetit për t'ia paraqitur dokumentet e mësipërme, brenda 3 (tri) ditëve, zyrës së policisë kufitare që e procedon.
4. Nëse dokumentet nuk paraqiten brenda afatit të parashikuar në pikën e mësipërme, mjeti lundrues i nënshtrohet bllokimit administrativ për 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë me urdhër të drejtuesit të zyrës së policisë kufitare kompetente. Shpenzimet e ruajtjes, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Rendit Publik, janë në ngarkim të kundërvajtësit.
5. Nëse dokumentet nuk paraqiten edhe brenda këtij afati, mjeti lundrues konfiskohet.
6. Personat, që gjenden në bordin e mjetit lundrues, shoqërohen në zyrat e policisë kufitare për verifikimin e identitetit të tyre, në bazë të nenit 45 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për policinë e shtetit".
7. Në rast se shkelja e parashikuar, në pikën 1, përsëritet, sanksioni administrativ dyfishohet.
8. Në rast se shkelja, e parashikuar në pikën 1, përsëritet më shumë se dy herë, sanksioni administrativ dyfishohet dhe zbatohet edhe dënimi plotësues i bllokimit të mjetit lundrues për 90 (nëntëdhjetë) ditë.

Neni 21

Refuzimi për paraqitjen e dokumenteve

1. Refuzimi për paraqitjen e dokumenteve të parashikuara në nenin 10 përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.
2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka bërë kontrollin, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në paragrafët 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.
3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 22

Mosbërja e deklarimit të importimit

1. Mosdeklarimi i importimit, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 11, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë, si dhe

me konfiskimin e mjetit lundrues.

2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 23

Mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes

1. Mosdeklarimi i zotërimit ose i mbajtjes, siç parashikohet në nenin 12, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.

2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 24

Mungesa e matrikullimit ose e regjistrimit

1. Pronësia, mbajtja ose zotërimi i një mjeti lundrues, objekt i këtij ligji, të pamatrikulluar ose të paregjistruar, sipas nenit 5, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë), deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.

2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, i cili ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në paragrafët 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 25

Ndryshimi ose falsifikimi i karakteristikave të mjetit lundrues

1. Ndryshimi ose falsifikimi i karakteristikave teknike të mjetit lundrues, i fuqisë së motorit ose të motorëve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë), deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.

2. Pronari, mbajtësi, zotëruesi dhe drejtuesi i mjetit lundrues, nëse kanë kërkuar ndryshimin ose falsifikimin, përgjigjen për bashkëpunimin në kundërvajtjen penale, të parashikuar në pikën 1.

3. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka vërtetuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

4. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 26

Përgjegjësia e fabrikave dhe e kantierëve detare

1. Shkelja e dispozitave të parashikuara nga pikat 1 e 2 të nenit 15 përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë.

2. Kur shkelja përsëritet më shumë se një herë, gjobës së parashikuar në pikën 1 i shtohet dënimi plotësues i mbylljes së fabrikës dhe të kantierit detar nga nëntëdhjetë, deri në njëqind e tetëdhjetë ditë.

3. Pronari dhe administratori i fabrikës ose i kantierit detar, nëse kanë urdhëruar zhvillimin e veprimtarisë së paligjshme, përgjigjen për bashkëpunimin në kundërvajtjen penale të përmendur në pikën 1 dhe gjoba dyfishohet.

4. Mbyllja e përkohshme vendoset në çastin e kontrollit nga oficeri i policisë kufitare dhe në këtë rast zbatohet procedura e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

5. Gjykata vendos brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së mbylljes të përkohshme.

Neni 27

Refuzimi i paraqitjes së regjistrave

1. Refuzimi nga pronari dhe administratori i fabrikës ose i kantierit detar për të paraqitur regjistrat, siç parashikohet në pikën 3 të nenit 15, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri në 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me dënimin plotësues të mbylljes së fabrikës ose të kantierit nga nëntëdhjetë deri në njëqind e tetëdhjetë ditë.

2. Mbyllja e përkohshme vendoset në çastin e kontrollit nga oficeri ose agjenti i policisë kufitare, i cili ka verifikuar shkeljen dhe zbatohet procedura e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Gjykata vendos brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së mbylljes të përkohshme.

Neni 28

Mosdeklarimi i ndryshimeve

1. Mosdeklarimi i ndryshimeve të parashikuara në pikën 1 të nenit 13, në nenin 14 dhe në pikat 1 e 2 të nenit 16 përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 50.000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100.000 (njëqind mijë) lekë.

2. Në rast se shkelja e parashikuar në pikën 1 përsëritet, gjoba dyfishohet.

3. Kur shkelja e parashikuar në pikën 1 përsëritet më shumë se dy herë, gjoba dyfishohet dhe zbatohet dënimi plotësues i bllokimit administrativ të mjetit lundrues për nëntëdhjetë ditë.

4. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

5. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga masa e sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 29

Zhvendosja ose përdorimi i mjetit pa autorizim

1. Zhvendosja ose përdorimi i mjetit lundrues, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 13, pikën 5 të nenit 18, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 100.000 (njëqind mijë) deri 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, si dhe me konfiskim të mjetit lundrues.

2. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parashikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

3. Në çdo rast sekuestrohet edhe mjeti i përdorur për transportin nga e për në vendin e përdorimit të mjetit lundrues.

4. Gjykata, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

Neni 30

Tejkalimi i numrit të personave që transportohen

1. Përveç sa parashikohet nga legjislacioni për lundrimin, transporti me mjetin lundrues i një numri personash, përfshirë ekuipazhin, më të lartë se ai i shënuar në lejen e lundrimit dhe në certifikatën e përdorimit, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me një gjobë prej 20.000 (njëzet mijë) lekësh

për çdo person mbi numrin e lejuar.

2. Tejkalimi i numrit të personave, që mund të transportohet, me më shumë se dhjetë veta përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) deri në 200.000 (dyqind mijë) lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.

3. Oficeri ose agjenti i policisë kufitare, që ka verifikuar shkeljen e parashikuar në pikën 2, sekuestron mjetin lundrues dhe respekton procedurën e parshikuar në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31.

4. Gjykata, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e masës së sekuestrimit, vendos për konfiskimin e mjetit lundrues.

PJESA E TETË

Neni 31

Veprimet e policisë gjyqësore

1. Oficeri i policisë gjyqësore i zyrës së policisë kufitare, përgjegjës për territorin, me vendim të gjykatës kontrollon në vendet ku ka të dhëna të bazuara se fshihen ose mbahen në mënyrë të paligjshme mjete lundruese, objekt i këtij ligji, në kundërshtim me nenet 11, 12, 17 e 18 të këtij ligji.

2. Oficeri i policisë gjyqësore mund të veprojë me nismën e vet në rastet e flagrancës, sipas kriterëve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

3. Në çdo rast, oficeri i policisë gjyqësore harton në tri kopje procesverbalin e kontrollit dhe të sekuestrimit të mundshëm të mjetit lundrues si element prove i veprës penale, ia dorëzon një kopje të procesverbalit të interesuarit nëse është i pranishëm, një kopje ia dërgon prokurorit përgjegjës dhe kopjen e tretë e arkivon në aktet e zyrës.

4. Në procesverbalin e parashikuar në pikën 3 duhet të shënohen deklaratat e çastit të bëra nga personi, nëse është i pranishëm, ndaj të cilit është bërë kontrolli.

5. Personit, të përmendur në pikën e mësipërme, i bëhet e ditur para fillimit të veprimeve, se mund të kërkojë mbrojtjen me avokat.

6. Oficeri i policisë gjyqësore i dërgon prokurorit procesverbalin e mësipërm brenda dyzet e tetë orëve, i cili brenda dyzet e tetë orëve në vijim vlerëson kontrollin.

Neni 32

Pjesët e mjeteve lundruese

Dispozitat e nenit të mësipërm zbatohen edhe kur bëhet fjalë për pjesë të mjeteve lundruese të cilat, në bazë të të dhënave të bazuara, të vendndodhjes, të mënyrës së fshehjes dhe të kushteve të parashikuara në pikën 5 të nenit 18 në ngarkim të pronarit ose të bashkëpronarëve, të mbajtësit ose të zotëruesit, që janë të destinuara për formimin ose montimin e mjeteve lundruese, sipas nenit 2.

PJESA E NËNTË

Neni 33

Lidhja me Kodin Penal dhe me ligjet e tjera të veçanta

Përveç sanksioneve të përmendura në shkeljet e veçanta të këtij ligji, zbatohen edhe ato të parashikuara nga Kodi Penal dhe nga ligjet e tjera të veçanta, në rastet kur me përdorimin e mjetit lundrues sipas nenit 2 kryhen vepra penale.

Neni 34

Zbatimi i Kodit të Procedurës Penale

Përveç procedurave të parashikuara në pikat 3, 4, 5 e 6 të nenit 31 të këtij ligji, zbatohen edhe

nenet e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 35

Ruajtja gjyqësore e mjeteve të sekuestruara e të konfiskuara

Mjetet lundruese, të sekuestruara e të konfiskuara në bazë të këtij ligji, i besohen në ruajtje Drejtorisë së Rezervave të Shtetit.

Neni 36

Përdorimi i mjeteve të konfiskuara

1. Mjetet lundruese të përshkruara në nenin 35, pasi konfiskohen, bëhen pronë e shtetit.
2. Drejtoria e Rezervave të Shtetit, sipas akteve ligjore, me kërkesë të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe me miratim të organeve përgjegjëse, mjetet lundruese të konfiskuara, ia jep në përdorim zyrave të policisë kufitare për kryerjen e detyrave.

Neni 37

Ankimi administrativ

1. Ndaj masave administrative të marra në bazë të këtij ligji, kundërvajtësi mund të bëjë brenda pesë ditëve ankim te Ministri i Rendit Publik, i cili vendos brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e ankimit.

Ndaj vendimit të Ministrit të Rendit Publik, brenda 5 ditëve, kundërvajtësi mund të bëjë ankim në gjykatë.

2. Paraqitja e ankimit dhe mënyra e shqyrtimit bëhet sipas dispozitave të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, me ndryshimet përkatëse.

Neni 38

Aktet nënligjore të ligjit

1. Ministri i Transportit nxjerr, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet e parashikuara në pikat 2 e 4 të nenit 6.

2. Ministri i Rendit Publik nxjerr, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet e parashikuara në pikën 1 të nenit 9 dhe në pikën 3 të nenit 20, si dhe rregullat për zbatimin e sanksioneve administrative.

3. Ministri i Rendit Publik, Ministri i Transportit dhe Ministri i Mbrojtjes nxjerrin, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktin e përbashkët të parashikuar në pikën 3 të nenit 14.

4. Ministri i Rendit Publik, Ministri i Transportit dhe Ministri i Mbrojtjes nxjerrin, brenda nëntëdhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çdo akt tjetër të përbashkët në zbatim të këtij ligji.

Neni 39

Dispozita kalimtare

1. Pronari ose bashkëpronarët, zotëruesi ose mbajtësi i mjeteve lundruese të fituara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të bëjnë deklaratat e parashikuara në pikën 1 të nenit 11 dhe në pikën 1 të nenit 12 brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Mosdeklarimi i parashikuar në pikën 1 përbën kundërvajtje penale dhe dënohet përkatësisht në bazë të neneve 22 dhe 23 të këtij ligji.

Neni 40

Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e ligjit nr.7873, datë 16.11.1994 “Për sekuestrimin e mjeteve tokësore, detare dhe ajrore me të cilat kryhen vepra penale” nuk zbatohen për mjetet lundruese objekt i këtij ligji.

2. Ligji nr.8440, datë 13.1.1999 “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese nën 20 NRT” dhe ligji nr.8616, datë 1.6.2000 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8440, datë 13.1.1999 “Për regjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese nën 20 NRT”” shfuqizohen.

Neni 41

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Shpallur me dekretin nr.2755, datë 23.9.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

L I G J

Nr.8665, datë 18.9.2000

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7748, DATË 29.7.1993 “PËR STATUSIN E ISH TË DËNUARVE DHE TË PËRNDJEKURVE POLITIKË NGA SISTEMI KOMUNIST”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Përmbajtja e nenit 10 të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” ndryshohet si vijon:

“Procesi i regjistrimeve për njohjen e së drejtës të statusit rifillon me hyrjen në fuqi të kësaj dispozite dhe do të vazhdojë deri më datën 31.12.2000.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2752, datë 22.9.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

V E N D I M

Nr.456, datë 18.9.2000

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 44 pika 2 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, si dhe të neneve 88 dhe 92 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

- I. Zgjidhet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, zoti Bajram Muça.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**V E N D I M
Nr.520, datë 21.9.2000**

PËR DHËNIE FONDI PËR PARTI TË REJA POLITIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- 1. T’u japë partive politike: “Forca Albania”, “Lëvizja punëtore shqiptare” dhe “Socialkristiane shqiptare”, nga një fond ndihme prej 100 000 (njëqind mijë) lekë secilës.
 - 2. Fondi prej 300 000 (treqind mijë) lekë të përballohet nga fondi rezervë për partitë e reja.
 - 3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Ilir Meta**

K Ë R K E S Ë

Kërkuese: Blerime Bida, e bija e Bajramit dhe Nailesë, lindur më Levan-Fier, e martuar me dy fëmijë.

Objekti: Shpalljen e zhdukjes së bashkëshortit tim të quajtur Sokol Bida, në bazë të nenit 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Unë kërkuesja Blerime Bida, kërkoj të shpallet i zhdukur bashkëshorti im Sokol Bida.

Në shtator të vitit 1997 ai u nis me gomone në Itali. Gjatë udhëtimit rezultohet se gomonia është mbytur. Sa më sipër kërkoj nga Gjykata të shpallet i zhdukur bashkëshorti im Sokol Bida.

**KËRKUESJA
Blerime Bida**

K Ë R K E S Ë
(PËR SHPALLJE TE ZHDUKUR)

Kërkuese: Kanerina Godelli (Kokalari), lindur ne Gjirokaštër dhe banuese në Tiranë, Rr. Bulevardi Dëshmorët e Kombit, pallati 32, Ap.22.

Objekti: Shpalljen të vdekur të Arziko Kokalarit dhe Avni Kokalarit, neni 388, i Kodit të Procedurës Civile, neni 15 e vijues i Kodit Civil.

Kërkuesja Kanerina Godelli ka bërë kërkesë për shpalljen të vdekur znj. Arziko Kokalari (Karagjozi) me 10 mars 1926 dhe Avni Kokalarit me datë 20 mars 1929 sepse dokumentet e gjendjes civile para vitit 1920 nuk ekzistojnë.

KËRKUESJA
Kanerina Godelli

Doli nga shtypi më 6.10.2000

Tirazhi: 3700 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Tipografia Ushtarake"

Çmimi: 150 lekë